



# Fibroza Kistike. Rehabilitimi Respirator (Rëndësia e Fizioterapisë)



*AKADEMIA Shëndet, Psikologji dhe Komunitet*

## 1. Synimet e kursit

“Fibroza Kistike. Rehabilitimi Respirator (Rëndësia e Fizioterapisë)” është një trajnim afatshkurtër i organizuar nga Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Akademia: Shëndet, Psikologji, Komunitet dhe BTTC (Barletti Training and Testing Center). Ky trajnim (teoriko-praktik) ka si qëllim përvetësimin e njohurive në lidhje me Fibrozën Kistike, rehabilitimin respirator dhe rëndësinë e fizioterapisë në sëmundjet kronike pulmonare. Ky trajnim sjell eksperiencën 40 vjeçare në trajtimin e fëmijëve me Fibrozë Kistike të Prof.Dr. Evda Veveçka, mjekë pediatre, e cila do të na informojë në lidhje me sëmundjen, prognozën dhe metodat më të fundit të trajtimit të saj. Profesionistët e shëndetësisë do të njihen me teknikat e pashtrimit të rrugëve respiratore, metodat e drenimit të sekrecioneve, teknikat e frymëmarrjes të demonstruara teorikisht dhe praktikisht nga Jola Xharo, fizioterapiste pediatrike. Ushtrimet specifike, sporti, aktiviteti fizik kanë një rol thelbësor në sëmundjet respiratore, gjë e cila evidentohet edhe më shumë në këtë trajnim.

## 2. Kush ka të drejtë të aplikojë

Pjesëmarrës në këtë trajnim “Fibroza Kistike.Rehabilitimi Respirator (Rëndësia e fizioterapisë)” mund të jenë:

- Profesionistë shëndetësorë që merren me trajtimin, rehabilitimin e sëmundjeve kronike pulmonare si : Mjekë të Përgjithshëm, pediatër, pneumologë, gastrohepatologë, gjenetistë, andrologë, endokrinologë, ortopedë, dietologë, mjekë laborator, fizioterapistë, infermierë.

-Studentë

## 3. Kohëzgjatja dhe mënyra e zhvillimit

Është një trajnim afatshkurtër një ditor për profesionistët që duan të aftësohen në teknikat, modalitetet rehabilituese për ti bërë ato pjesë të seancave të trajtimit të tyre.

Zhvillohet në 1 ditë:

Data 01/04/2023.

Orari: 08:30-16:30.

## 4. Përmbajtja e programit të trajnimit

Trajnimi është i organizuar në leksione interaktive, diskutime në grup dhe praktikë. Me një kombinim të të tre metodave arrihet në një përvetësim më të mirë të teknikave nga profesionistët.

## 5. Organizimi i trajnimit

Trajnimi " Fibroza Kistike. Rehabilitimi Respirator (Rëndësia e Fizioterapisë)" është një trajnim dinamik profesional i cili ka 6 kredite dhe është i akredituar nga ASCK. Trajnimi organizohet në 1 ditë pranë Universitetit Barleti dhe frekuentimi i trajnimit është i detyrueshëm, gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij qoftë në pjesën praktike apo teorike.

## 6. Vendi i zhvillimit të trajnimit

Trajnimi do të zhvillohet fizikisht në Universitetin Barleti. Veprimtaria mësimore përfshin leksione interaktive dhe prezantime nga trajnuesit, diskutime në grup dhe demonstrimi në praktikë i të gjitha teknikave të përfshira.

## 8. Certifikimi

Trajnimi është i akredituar nga ASCK me 6 kredite.

## 7. Mundësitë e punësimit dhe karriera

Certifikata e këtij kursi të formimit të vazhduar ndihmon në rritjen profesionale të pjesëmarrësve duke i ofruar atyre një mjet të ri terapeutik për ti bërë një qasje multidimensionale pacientit gjatë trajtimit.

## 9. Garancia e programit të trajnimit

Universiteti Barleti, veçanërisht nëpërmjet sekretarisë mësimore e zyrës së pranimit por edhe strukturave të tjera në varësi, ka përgjegjësitë e mëposhtme:

T'u mundësojë studentëve gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me rregulloren, politikën e zhvillimit të programit, kriteret e pranimit, planin dhe programet mësimore, rregullat e vlerësimit, rregullat e praktikës, rregullat e çertifikimit, rregullat financiare.

Të zbatojë të gjitha kriteret profesionale dhe pedagogjike për mësimdhënien, praktikën, vlerësimin.

Të nxitë studentët të marrin pjesë në veprimtaritë e UniBa.

Të mbështesë studentët në plotësimin e kërkesave që lidhen me zbatimin e programit të studimit.

Të krijojë kushtet e përshtatshme për realizimin e programit (të sigurojë mjediset, rrjetin e informacionit, të vërë në dispozicion bibliotekën, mjetet mësimore dhe teknologjinë elektronike).